

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Mbi Auditimin e fondeve te perfituara dhe shpenzimet e kryera nga Partia per Demokraci dhe Solidaritet per Fushaten zgjedhore te dates 21.06.2015

- KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

TIRANE

Une kam kryer auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga **Partia per Demokraci dhe Solidaritet**, me seli ne qytetin Tirane, gjate fushates zgjedhore per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore te Shqiperise te dates 21.06.2015. Auditimi eshte bere bazuar ne Vendimin nr.969 date 10.08.2015 dhe ne Kontraten e sherbimit te dates 05.10.2015 te lidhur mes nesh (palese).

Pergatitja e argumentimi i pasqyres se fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate gjithe fushates zgjedhore per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore nga Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise.

Pregjegjesia e Drejtimit

Pregjegjesia dhe detyra e subjektit zgjedhor Partia per Demokraci dhe Solidaritet eshte qe politika kontabel e ndjekur nga ana e tij, pergatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare mbi bazen e arketimeve dhe pagesave te kryera ne fakt. Mbi kete baze, e ardhura eshte njohur kur eshte arketuar dhe shpenzimet ne momentin e pagesave.

Pregjegjesia e Audituesit

Pregjegjesia ime eshte te shpreh nje opinion mbi keto te dhena (pasqyre) bazuar ne auditimin tim.

Auditimin e kam kryer ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA) me reference te vecante SNA-800 (Raport i audituesit mbi angazhime auditimi per qellime te vecanta) mbeshtetur ne kontraten e dates 05.10.2015. Standartet kerkojne qe te planifikojme dhe te kryejme auditimin per te zoteruar siguri te arsyeshme se keto dokumenta te fushates zgjedhore nuk permbajne anomali materjale. Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyren financiare te arketim pagesave per fondet e perfituara dhe te shpenzuara.

Auditimi perfshine gjithashtu vleresimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vleresimet e rendesishme te bera nga Drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyres.

Une cmoj se auditimi perben nje baze te arsyeshme per te shprehur opinionin tim.

Per mendimin tim, pasqyrat bashkelidhur japin nje pamje te vertete e te sinqerte te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara, te deklaruar nga subjekti zgjedhor **Partia per Demokraci dhe Solidaritet** gjate fushates zgjedhore ne zgjedhjet e dates 21

qershor 2015 per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore ne perputhje me bazen e arketimeve e pagesave, sic pershkruhet ne shenimet bashkelidhur.

Baza e Kontabilitetit dhe Kufizimi ne Shperndarje e Perdorim.

Pa modifikuar opinionin, kam terhequr vemendjen per evidentimin e kontabilizimin e veprimeve te kryera gjate fushates zgjedhore. Pasqyrat financiare jane pergatitur per te ndihmuar subjektin **Partia per Demokraci dhe Solidaritet** per te qene ne pajtim me dipozitat e raportimit financiar te kontrates se permendur me siper. Si rezultat i kesaj pasqyrat financiare mund te mos te jene te pershtateshme per ndonje qellim tjeter.

Raporti parashikohet vetem per Juve dhe subjektin zgjedhor Partia per Demokraci dhe Solidaritet dhe nuk duhet te shperndahehet dhe perdoret nga pale te tjera.

Durres me 14.11.2015

Adresa: -Lagja nr.1, Rruga Taulantia, Pallati Teuta, Durres
-Tel: 052224666, cel. 0682145169
-Email: azemhyka@gmail.com

Audituar nga:
Ekspert Kontabel i Autorizuar
Azem HYKAJ



AZEM HYKAJ
EKSPERT KONT. AUTORIZ.
NR. LIC. 413801-ALBA

Pasqyre Permbledhese

Per Fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera nga Partia per Demokraci dhe Solidaritet gjate fushates zgjedhore per zgjedhjen e Organeve te qeverisjes vendore.

Nga te dhenat e paraqitura dhe te audituara rezulton:

1 - Fonde te perfituara gjithsej	110.000 leke
2 - Shpenzime: - Ne euro	0 euro
- Ne lek	110.000 leke
3 - Diferenca: - Ne euro	0 euro
- Ne leke	0 leke

Ekspert kontabel i autorizuar
Azem HYKAJ



Stamp: EKSPERT KONT. AUTORIZ. NR. LIC. 415891 ALBA

Shenime te Audituesit te Pavarur

Mbi pasqyrat financiare per fondet te perfituara dhe shpenzimet e kryera nga subjekti Partia per Demokraci dhe Solidaritet gjate fushates zgjedhore per Zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore te dates 21.06.2015.

1- Administrimi dhe vleresimi i mbajtjes se kontabilitetit

Subjekti zgjedhor **Partia per Demokraci dhe Solidaritet** drejtohet nga organet drejtuese te saj sipas statutit te miratuar dhe qe eshte i rregjistruar ne dokumentacionin qe rregullon krijimin dhe funksionimin e partise, te cilet ndjekin dhe menaxhojne aktivitetin e perditeshem te saj.

Kontabiliteti mbahet ne menyre manuale nga specialist te ngarkuar qe kryen rregjistrimet kontabile ne libra e ditare te permbledhura ne pasqyrat e hartuara me kompiuter ne programin microsoft excel sipas planit te llogarive te programit kontabel. Kontabiliteti eshte mbajtur sipas kerkesave te Ligjit "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe te akteve te tjera ligjore e nen ligjore ne fuqi.

2 - Auditimi

Per periudhen e fushates se zgjedhjeve per Zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore te mbyllur me 21 qershor 2015, kam verifikuar shifrat e rregjistruara ne kontabilitet dhe kam konstatuar se jane te barabarta me ato te dokumentuara ne librin e arkes, por jane regjistruar ne te njejtin ditar arke, ndersa ndarja e tyre eshte bere ne pasqyra te vecanta ne menyre ekstra kontabel.

Cdo element i fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore eshte ne postin e vet dhe shifrat rakordojne me shifrat e pasqyruara ne dokumentacionin e prodhuar dhe te perdorur per kete qellim.

Gjate auditimit, krahas respektimit te SNA-800, kam perdorur dhe respektuar kerkesat e ligjit nr.10019 date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise", kreun e dyte te tij, vendimin nr. 226 date 01.06.2009 te KQZ, ligjin 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe cdo dokument te paraqitur nga Partia per Demokraci dhe Solidaritet.

Kam perdorur metoden e ballafaqimit te fakteve te dokumentuara qe me jane paraqitur me regjistrimin e tyre ne kontabilitet, gjithmone faktet jane testuar. Nisur nga ky qellim eshte bere edhe nje testim i pergjithshem me anen e nje pyetesori te ndertuar ne formen e deklarates personale per fondet e perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore bazuar ne kerkesat e kreut te dyte te kodit zgjedhor dhe te vendimit te kqz te nxjerre per kete qellim.

3 - Respektimi i parimeve dhe rregullave

Bazuar ne kuadrin ligjor te cituar me lart dhe mbi bazen e auditimit te dokumentacionit te paraqitur dhe te perpunuar, mua me rezulton qe kjo parti:



- nuk ka perfituar financime nga fondet publike (buxheti i shtetit) sipas Kodit zgjedhor, por nga perllogaritjeve te bera nga ky subjekt pas nxjerrjes se rezultatit te zgjedhjeve, KQZ duhet ta financoje me 325.000 leke.
- nuk ka perdorur burime publike te tjera qe i ndalon neni 88 i kodit zgjedhor,
- jane respektuar kerkesat e nenit 89 te kodit zgjedhor per pavaresine e deklarimeve nga subjekti financues.
- eshte mbajtur regjistri i posacem por nuk ka raste te dokumentuara per deklarimin e pergjegjesise se dhuruesit (financuesit).
- me rezulton qe nuk eshte hapur llogari e vecante bankare per veprimet qe do te kryhen gjate fushates se zgjedhjeve dhe nuk ka raportim ne kqz per kete qellim ashtu sic percakton pika 2 e nenit 90 e kodit zgjedhor.
- Jane bere 110.000 leke shpenzime te dokumentuara gjate fushtes te cilat nuk kalojne 10 fishin e fondeve te perfituar (nuk ka te tilla)
- per shpenzimet e dokumentuara pjeserisht jane respektuar kerkesat e legjislacionit tatimor ne fuqi
- veprimet financiare per fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore jane bere vetem nepermes arkes dhe jane te regjistruara ne ditarin perkates ne excel.

Nuk kam pretendime per pengesa ne paraqitjen e dokumentacionit te kerkuar pavaresisht nga varferia e tij, por cdo deklarim me pergjegjesi personale theksoj qe eshte respektuar nga palet.

4 – Pasqyrimi i fondeve te perfituara dhe te shpenzuara

Sic paraqitet ne pasqyren permbledhese, mua me rezulton se fondet e perfituara te regjistruar ne ditarin e arkes per qellime zgjedhore jane te vogla. Prandaj ve theksin qe ky subjekt zgjedhor gjate fushates ka perdorur edhe mjete te veta financiare te akumuluar, pa dashur te bej aludime te tjera qe nuk jane te faktuara e te dokumentuara.

Ne perfundim shtoj qe raporti standart per dhenien e opinionit nga ana e ime ne menyre te permbledhur eshte mbeshtetur mbi bazen e ketyre shenimeve.

Materjali ne origjinal eshte prodhuar ne dy kopje, njera i dorezohet KQZ-se si institucioni porosites kontraktual dhe tjetra subjektit zgjedhor *Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise* si subjekt i audituar.

Ky material mund te perdoret **vetem** per qellime qe percakton Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise.

Ekspert Kontabel i Autorizuar

Azem HYKAJ

Azem Hykaj
 EKSPERT KONTABEL
 NR. LIC. 415/01 ALBB

Durres me 15.11.2015